



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË
GJYKATA KUSHTETUESE
KOLEGJI I POSAÇËM I APELIMIT**

Nr. 85 regjistër (JR)
Datë 30.12.2021

Nr. 61 i vendimit
Datë 25.11.2024

**VENDIM
NË EMËR TË REPUBLIKËS**

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit, i përbërë nga gjyqtarët:

Albana Shtylla	Kryesuese
Natasha Mulaj	Relatore
Sokol Çomo	Anëtar
Rezarta Schuetz	Anëtare
Mimoza Tasi	Anëtare

– mori në shqyrtim në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, më datë 25.11.2024, ditën e hënë, në orën 11:10, në ambientet e Kolegjit të Posaçëm të Apelit, në prani të Vëzhguesit Ndërkombëtar Francesco Ciardi, me Sekretare Gjyqësore Adelajda Olldashi, çështjen e Juridiksionit të Rivlerësimit, që i përket:

ANKUES: Subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë.

OBJEKTI: Shqyrtimi i vendimit nr. 472, datë 04.11.2021, i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Nazmi Troka.

BAZA LIGJORE: Neni 179/b pika 5 e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

Trupi gjykues i Kolegjit të Posaçëm të Apelit,

pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi, në përputhje me parashikimet e nenit 65 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 84/2016”), shqyrtoi shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit, i cili përfundimisht kërkoi konfirmimin e tij në detyrë, dëgjoi gjyqtaren relatores të çështjes Natasha Mulaj, si dhe pasi e bisedoi atë,

VËREN:

I. Në lidhje me rrethanat e çështjes

1. Subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka (në vijim “subjekti i rivlerësimit”) ka ushtruar funksionin e gjyqtarit pranë Gjykatës së Apelit Vlorë. Bazuar në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, si dhe në ligjin nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit i është nënshtruar procesit të rivlerësimit kalimtar *ex officio*, të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë.
2. Në funksion dhe në zbatim të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka plotësuar dhe dërguar pranë institucioneve kompetente dhe brenda afatit ligjor, në përputhje me nenin 31, pika 1, nenin 35, pika 1 dhe nenin 41, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, përkatësisht deklaratën e pasurisë, deklaratën për kontrollin e figurës, si dhe formularin për vetëvlerësimin profesional. Në vijim të zhvillimit të procesit të rivlerësimit për subjektin e rivlerësimit, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), bazuar në përcaktimet e neneve 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016, ka administruar raportet e hartuara nga institucionet: (a) Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (në vijim “ILDKPKI”); (b) Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (në vijim “DSIK”); dhe (c) Këshilli i Lartë i Prokurorisë (në vijim “KLP”), prej të cilave rezultoi si më poshtë.
3. ILDKPKI-ja, pasi kreu procedurën e kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit, në zbatim të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016, dërgoi pranë Komisionit një raport të hollësishëm dhe të arsyetuar, me nr. {***} prot., datë 30.03.2018, duke konstatuar se:
 1. *Deklarimi nuk është i saktë, në përputhje me ligjin.*
 2. *Ka mungesë dokumentacioni justifikues ligjor për burimin e krijimit të pasurive.*
 3. *Nuk ka kryer fshehje pasurie ndër vite.*
 4. *Nuk ka kryer deklaram të rremë.*
 5. *Subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*
4. Në përputhje me nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës dhe me nenin 4 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni, pasi administroi raportet e vlerësimit të hartuara për subjektin e rivlerësimit, vlerësoi se provat e administruara deri në seancën dëgjimore, në lidhje me vlerësimin e pasurisë, kishin arritur nivelin e provueshmërisë dhe ishin të mjaftueshme për përfundimin e procesit administrativ duke u bazuar vetëm mbi këtë kriter, në përputhje me pikën 2 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016. Bazuar në provat e administruara, raportin dhe rekomandimet e relatorit, si dhe pasi shqyrtoi të gjitha

pretendimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni arriti në përfundimin që subjektit të rivlerësimit Nazmi Troka, gjyqtar pranë Gjykatës së Apelit Vlorë, me vendimin objekt shqyrtimi nr. 472, datë 04.11.2021, t'i jepet masa disiplinore e shkarkimit nga detyra.

5. Vendimi i Komisionit për shkarkimin e subjektit nga detyra, është marrë në vijim të konkluzioneve të mëposhtme për kriterin e pasurisë.

(i) Nuk ka arritur të shpjegojë bindshëm burimet e ligjshme të pasurive, në përputhje me nenin D të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjin nr. 84/2016.

(ii) Ka mungesë të burimeve financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë dhe kryerjen e shpenzimeve, në përputhje me germën "b" të pikës 5 të nenit 33 të ligjit nr. 84/2016.

(iii) Ka mungesë dokumentacioni provues për të ardhurat e deklaruara nga pemëtaria.

(iv) Ka deklaram të pamjaftueshëm për kriterin e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016.

(v) Subjekti ka ushtruar aktivitetin privat të fermerit në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit.

II. Mbi ankimin dhe shkaqet e ngritura nga subjekti i rivlerësimit

6. Subjekti i rivlerësimit ka ushtruar ankim më datë 21.12.2021, kundër vendimit nr. 472, datë 04.11.2021, të Komisionit, i cili është protokolluar me nr. {***}. Ankimi është paraqitur brenda afatit ligjor, sipas nenit 63¹, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, nënshkruar nga vetë subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet të cilit kërkoi ndryshimin e vendimit nr. 472, datë 04.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, dhe konfirmimin e tij në detyrë. Subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi dokumentacion bashkëngjitur ankimit.

Shkaqet e ankimit të subjektit të rivlerësimit paraqiten në mënyrë të përmbledhur si më poshtë.

Shkaqet e ankimit me natyrë procedurale

6.1 Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se vendimi i Komisionit është mbështetur në interpretim të gabuar të ligjit dhe të provave të shqyrtuara dhe se konkluzioni i Komisionit për shkarkimin e tij nga detyra ka qenë i njëanshëm për faktin se kreu rivlerësimin kalimtar të subjektit vetëm me një kriter, atë të pasurisë, duke paragjykuar çështjen dhe duke shkelur nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës.

Shkaqet e ankimit lidhur me vlerësimin e pasurisë

6.2. Lidhur me pasurinë shtëpi banimi, dykatëshe, me sip. 99 m², ndodhur në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Kuçovë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se nuk u provua përfundimi i ndërtimit të shtëpisë së banimit në fshat në vitin 1994. Subjekti pretendon se kati i dytë është ndërtuar gjatë periudhës 1991-1994, duke përdorur materialet që përfituan nga shpërbërja e ish-kooperativave

¹ "Të gjitha vendimet e Komisionit ankimohen në Kolegjin e Apelimeve nga subjekti i rivlerësimit dhe/ose Komisioneri Publik, 15 ditë nga data e njoftimit të vendimit të Komisionit".

bujqësore. Në lidhje me vlerën e ndërtimit të shtëpisë, subjekti shpjegon se 3.500.000 lekë është deklaruar në deklaratën *vetting*, pasi është llogaritur se sa do të kushtonte ajo me çmimin e tregut në vitin 1996, referuar VKM-së me nr. 815, datë 09.12.1996.

Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh financiare të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë së banimit në shumën (-) 1.534.073 lekë, subjekti pretendon se është përfundim *apriori* dhe i pambështetur në prova. Subjekti ka paraqitur analizën e tij ekonomike për periudhën 1994-2000, e cila rezulton me diferencë pozitive në shumën prej 1.801.391 lekësh.

6.3 Lidhur me pasurinë apartament banimi me sip. 64 m², ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se huadhënësi A. M. ka pasur burime financiare të ligjshme për t’i dhënë hua subjektit shumën prej 25.000 eurosh për blerjen e apartamentit. Subjekti pretendon se llogaria bankare e kumatit është shtuar gradualisht nga viti 2000 deri në vitin 2014, për këtë arsye ka vënë në dispozicion të Komisionit të ardhurat e z. M.. Gjithashtu, subjekti pretendon se nuk e ka detyrim të kryejë analizën financiare të kumatit të tij, që nga viti 2000, sepse ky i fundit i ka pasur paratë në sistemin bankar dhe verifikimin e burimit të tyre e ka kryer banka në momentin e depozitimit të shumës nga z. M..

6.4 Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të vitit 2015, të kryer nga Komisioni në lidhje me shlyerjen e 7.000 eurove huadhënësit A. M.. Sipas subjektit të rivlerësimit, në analizën e Komisionit duhet të ishin marrë në konsideratë pretendimet e tij në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës dhe gjithashtu në lidhje me konsiderimin e të ardhurave nga pemëtaria, nga përlllogaritja e të cilave do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të kryente shlyerjen e huasë në shumën 7.000 euro dhe përballimin e shpenzimeve të vitit.

6.5 Lidhur me shpenzimet e jetesës, subjekti i rivlerësimit kundërshton *analizën financiare të Komisionit për vitin 2016*, pasi nuk i janë konsideruar të reduktuara sipas pretendimit të tij dhe gjithashtu nuk janë marrë në konsideratë as të ardhurat nga pemëtaria sipas aktit të ekspertimit të paraqitur nga subjekti në Komision. Subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës janë përballuar nga të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe jo nga të ardhurat nga paga, ndaj ulja e shpenzimeve nga Komisioni me 50% nga ato përlllogaritura nga INSTAT-i, nuk është e mjaftueshme, pasi shpenzimet e shportës duhet të jenë në vlerën 30% të të ardhurave neto. Gjithashtu subjekti pretendon t’i konsiderohet gjendja *cash* në shumën 1.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, të cilën sqaron se e ka krijuar nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes, si dhe të ardhurat e realizuara nga pemëtaria.

6.6 Subjekti i rivlerësimit kundërshton përfundimin e Komisionit se fakti i ushtrimit të veprimtarisë së fermerit është në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit. Subjekti shpjegon se në analizë të nenit 143 të Kushtetutës, nuk ndalohet kjo veprimtari e fermerit, ndaj nuk mund të jetë në papajtueshmëri me këtë dispozitë kushtetuese.

IV. Vlerësimi i trupit gjykues të Kolegjit të Posaçëm të Apelimit

A. Mbi procesin gjyqësor në Kolegj

i. Juridiksioni i Kolegjit

7. Në përputhje me nenin 179/b, pika 5 e Kushtetutës dhe nenin F, pikat 1 dhe 2 të Aneksit të Kushtetutës, Kolegji ka juridiksion (*ratione materiae*) ndaj ankimeve kundër vendimeve të Komisionit, lidhur me rivlerësimin kalimtar të subjekteve të rivlerësimit, të parashikuar nga neni 179/b, pikat 3 dhe 4, përveç rasteve të vendimeve të dhëna, sipas nenit E, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, çështja në shqyrtim, për sa kohë ka në objekt kundërshtimin e një vendimi të Komisionit, i cili ka kryer rivlerësimin e subjektit Nazmi Troka, duke vendosur shkarkimin e tij nga detyra, bën pjesë në juridiksionin e Kolegjit, i cili merr në shqyrtim ankimet ndaj vendimeve të Komisionit, sipas rregullave të përcaktuara në nenin 65 të ligjit nr. 84/2016.

ii. Legjitimimi i ankuesit

8. Ankuesi legjitimohet *ratione personae*, në kuptim të nenit 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neneve C, pika 2 dhe F, pika 2 e Aneksit të Kushtetutës, si dhe nenit 63, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, si dhe *ratione temporis*, pasi ankimi është depozituar pranë Komisionit brenda afatit ligjor prej 15 ditësh nga data e njoftimit të vendimit të arsyetuar, në përputhje me parashikimet e nenit 63, pikat 1 dhe 2 të ligjit nr. 84/2016.

iii. Forma dhe mënyra e shqyrtimit të ankimit

9. Në përputhje me nenin 65, pika 1² e ligjit nr. 84/2016, si rregull, shqyrtimi i ankimit në rastin kur vendimi i Komisionit ankohet nga subjekti i rivlerësimit, kryhet në dhomë këshillimi. Trupi gjykues i Kolegjit vlerësoi kryesisht se: (a) *konstatimi i gjendjes faktike është bërë nga Komisioni në mënyrë të plotë dhe të saktë dhe, për pasojë, nuk nevojitet vërtetimi i fakteve të reja dhe marrja e provave të reja;* (b) *nuk konstatohen shkelje të rënda procedurale që të kenë ndikuar në vendimmarrje apo gjendje faktike të konstatuara gabim dhe në mënyrë jo të plotë nga Komisioni;* si dhe (c) *nuk është e nevojshme përsëritja e marrjes së disa apo të gjitha provave të administruara në Komision, për rrjedhojë, çështja duhet të vijojë të shqyrtohet në seancë gjyqësore në dhomë këshillimi mbi bazë dokumentesh, sipas parashikimit të nenit 49 të ligjit nr. 49/2012, pasi në asnjë rast nuk ndodhemi përpara kërkesave ligjore të nenit 51, pika 1 e ligjit nr. 49/2012.*

B. Mbi shqyrtimin e shkaqeve të ankimit

Analizimi i shkaqeve procedurale të ankimit

10. Subjekti i rivlerësimit pretendoi në ankim se vendimi i Komisionit është mbështetur në interpretim të gabuar të ligjit dhe të provave të shqyrtuara dhe se konkluzioni i Komisionit për shkarkimin e

² “Procesi gjyqësor në Kolegjin e Apelimit kryhet në përputhje me rregullat e parashikuara në nenet 47, 48, pika 1; 49, 51 dhe 55 të ligjit nr. 49/2012 “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

tij nga detyra ka qenë i njëanshëm për faktin se kreu rivlerësimin kalimtar të subjektit vetëm me një kriter, atë të pasurisë, duke paragjykuar çështjen dhe duke shkelur nenin Ç, pika 1 e Aneksit të Kushtetutës, sipas të cilit rivlerësimi përfshin kontrollin e pasurisë, figurës dhe aftësive profesionale. Sa më sipër, subjekti kërkon nga Kolegji të korrigohet ky gabim procedural i Komisionit, të riçelet hetimi administrativ dhe të vlerësohen me objektivitet tri kriteret, duke përfshirë edhe kontrollin e figurës dhe aftësive profesionale.

10.1 Në analizë të këtij pretendimi të subjektit të rivlerësimit, trupi gjykues i Kolegjit sjell në vëmendje se neni 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, parashikon se: *Komisioni dhe Kolegji i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit. Vendimi merret bazuar në një ose disa prej kriterëve, në vlerësimin e përgjithshëm të tri kriterëve, ose në vlerësimin tërësor të procedurave.* Pra, vendimi në procesin e rivlerësimit për subjektet e rivlerësimit mund të merret bazuar në një ose disa prej kriterëve të rivlerësimit, që do të thotë se nëse në një moment të caktuar të zhvillimit të procedurës hetimore administrative nga ana e Komisionit, ky i fundit arrin në përfundimin se ekzistojnë shkaqe për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit, bazuar në rezultatet e arritura nga procedura për vlerësimin edhe vetëm të një kriteri, ligji e lejon Komisionin të mbyllë procedurën e rivlerësimit për atë kriter, mbi bazën e parimeve të procesit të rregullt, si dhe duke respektuar të drejtat themelore të subjektit të rivlerësimit, dhe të marrë një vendim për shkarkimin e tij, pa qenë e nevojshme që procedura administrative të vazhdojë më tej me verifikimin e kriterëve të tjera.

10.2 Kur Komisioni çmon se provat kanë një nivel të tillë provueshmërie sipas parashikimeve të nenit 52 të ligjit nr. 84/2016, lexuar në harmoni me nenin 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016 dhe interpretimi logjik i nenit 59, pika 1 e ligjit nr. 84/2016, që bëjnë të besohet se subjekti i rivlerësimit gjendet para prezumimit ligjor të vendosjes së masës disiplinore të shkarkimit nga detyra, atëherë është e mundur vendimmarrja për vetëm një ose dy kriterë vlerësimi. Pavarësisht vendimit që mund të merret në këtë fazë, për të mbyllur hetimin administrativ mbështetur vetëm mbi një ose dy kriterë, Komisioni, në funksion të zhvillimit të një procesi të drejtë e në respektim të së drejtës së subjektit të rivlerësimit për t'u dëgjuar e mbrojtur, mundet ta revokojë këtë vendimmarrje pas kryerjes së seancës dëgjimore e analizës së pretendimeve të subjektit, krahas provave të administruara nga hetimi, dhe të vazhdojë procedurën hetimore administrative edhe për komponentët e tjerë. Ndërkohë që parashikimi i nenit 59 të ligjit nr. 84/2016 kërkon që, për konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, Komisioni duhet detyrimisht të vlerësojë tri kriteret në mënyrë kumulative. Në nenin 59 të ligjit nr. 84/2016, është mirëpërcaktuar se, me qëllim konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, kërkohet që ai të plotësojë kushtet e kërkuara për tri kriteret, duke arritur nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë; nivel të besueshëm në kontrollin e figurës dhe një nivel minimal kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

10.3 Në funksion të nenit 4, pika 2 e ligjit nr. 84/2016, del i qartë interpretimi që institucionet e rivlerësimit mund ta marrin vendimin mbi bazën e një kriteri vlerësimi ose të disa kriterëve, si dhe në vlerësimin e tri kriterëve apo në vlerësimin e përgjithshëm të tyre, ose në vlerësimin tërësor të

procedurave të një ose disa kriterëve të rivlerësimit, qëndrim ky i mbajtur në jurisprudencën³ e Kolegjit. Komisioni dhe Kolegji kanë të drejtë për të konkluduar me vendim, qoftë edhe vetëm për njërin nga kriteret dhe, bazuar në nenin D të Aneksit të Kushtetutës, konkretisht për kriterin e pasurisë, Kushtetuta parashikon shkarkimin nga detyra për ato raste të deklarimit të pasurisë të parashikuara në këtë dispozitë, siç është përpjekja për të fshehur apo paraqitja në mënyrë të pasaktë e pasurive. Për sa më sipër, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se shkak i ankimit të subjektit të rivlerësimit se procesi i tij i rivlerësimit është kryer në interpretim të gabuar të ligjit, pasi është konkluduar vetëm për një kriter, nuk gjendet i bazuar.

10.4 Në vlerësim të pretendimit të subjektit të rivlerësimit se Komisioni është treguar i njëanshëm, i referohemi qëndrimit të mbajtur në jurisprudencën e Gjykatës Kushtetuese⁴ dhe atë të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut⁵, sipas së cilave ekzistenca e paanësisë duhet të vlerësohet në bazë të dy kriterëve, atij të vlerësimit subjektiv, sipas të cilit duhet të merret në konsideratë bindja personale dhe sjellja e gjyqtarit, domethënë nëse ky i fundit ka shfaqur ndonjë paragjykim apo qasje personale, dhe atij të vlerësimit objektiv, sipas të cilit duhet siguruar nëse gjykata, në drejtim të përbërjes së saj, ofron garanci të mjaftueshme për të përjashtuar çdo dyshim legjitim në lidhje me paanësinë e saj. Në kuadër të vlerësimit objektiv, është e nevojshme që të verifikohet nëse ekzistojnë fakte të cilat ngrenë dyshime mbi paanësinë e komisionerëve. Kjo nënkupton se, për të përcaktuar nëse në një çështje ka një arsye legjitime për t'u shqetësuar se një anëtar apo një trup gjykues tregon mungesë paanësie, këndvështrimi i personit të interesuar është i rëndësishëm, por jo vendimtar. Vendimtare është nëse ky shqetësim i palës mund të justifikohet në mënyrë objektive. Sa i takon vlerësimit subjektiv, GjEDNj-ja i ka qëndruar vazhdimisht parimit se “paanësia personale e gjyqtarit duhet të merret e mirëqenë deri në momentin kur provohet e kundërta”. Subjekti i rivlerësimit nuk identifikoi rrethana konkrete apo sjellje subjektive për anëtarët e Komisionit gjatë hetimit administrativ, për t'i vlerësuar nëse përbëjnë sjellje të njëanshme që kanë kompromentuar procesin e rregullt ligjor, si rrjedhojë pretendimi se Komisioni ka qenë i njëanshëm për shkarkimin e subjektit nga detyra, nuk gjendet i bazuar.

Shkaqet e ankimit të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit lidhur me kriterin e pasurisë dhe vlerësimi i tyre nga Kolegji

- 11.** *Lidhur me pasurinë shtëpi banimi dykatëshe, me sip. 99 m², ndodhur në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Kuçovë, subjekti i rivlerësimit pretendon se nuk qëndron konkluzioni i Komisionit se nuk u provua përfundimi i ndërtimit të shtëpisë së banimit në fshat në vitin 1994. Në lidhje me vlerën e ndërtimit të shtëpisë, subjekti shpjegon se ka qenë*

³ *Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 9/2018 (JR), paragrafi 44; nr. 11/2018 (JR), paragrafi 5; nr. 2/2019 (JR), paragrafi 35.2; nr. 15/2019 (JR), paragrafi 119; nr. 34/2019 (JR), paragrafi 55.1; nr. 20/2020, paragrafët 14.1, 14.2, 14.3.*

⁴ *Vendimet e Gjykatës Kushtetuese nr. 46, datë 19.07.2016; nr. 49, datë 10.07.2015; nr. 21, datë 29.04.2010; nr. 12, datë 13.04.2007.*

⁵ *Fey kundër Austrisë, 1993; Pullar kundër Mbretërisë së Bashkuar, 1996; Micallef kundër Maltës, 2009; Kyprianou kundër Qipros, 2005.*

në shumën prej 1.200.000 lekësh, ndërsa vlera prej 3.500.000 lekësh është deklaruar në deklaratën *vetting*, pasi është llogaritur se sa do të kushtonte ajo me çmimin e tregut në vitin 1996, referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 09.12.1996, “Për miratimin e vlerave mesatare vjetore të apartamentit tip në tregun e lirë dhe vlerës së koeficientit “K””.

Subjekti sqaron në ankim se, me anë të një situacioni ndërtimi të kryer nga inxhinier ndërtimi, i ka provuar Komisionit se kostoja e kësaj banese është 1.200.000 lekë për periudhën e ndërtimit 1990-1994. Subjekti pretendon se vlera e konsideruar nga Komisioni si shpenzim për ndërtimin e shtëpisë, në shumën prej 3.105.538 lekësh, është e pasaktë sepse i përket vlerës së tregut pas viteve 1996, dhe jo koston së ndërtimit të një shtëpie në fshat, të ndërtuar me materiale të përfituara nga shpërbërja e ish-kooperativës bujqësore dhe të ndërtuar në mënyrë private.

Në lidhje me konkluzionin e Komisionit se subjekti i rivlerësimit ka pasur mungesë burimesh të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë, në shumën prej (-) 1.534.073 lekësh, subjekti pretendon se është përfundim *apriori* dhe i pambështetur në prova, pasi kjo diferencë negative rezulton nga përllogaritja e vlerës së ndërtimit të shtëpisë në shumën 3.105.538 lekë, dhe jo 1.200.000 lekë që ka kushtuar realisht. Subjekti ka paraqitur analizën e tij ekonomike për periudhën 1994-2000, e cila rezulton me diferencë pozitive në shumën prej 1.801.391 lekësh.

11.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Trupi gjykues, për këtë pasuri, arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka mungesë të burimeve të ligjshme për ndërtimin e shtëpisë dykatëshe, për periudhën 1994 – 2000, në shumën (-) 1.534.073 lekë. Për sa më sipër, nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për ndërtimin e shtëpisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar ndërtimin e shtëpisë.*

11.2 Sipas dokumentacionit në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar vlerën e kësaj pasurie në shumën 3.500.000 lekë, me burim krijimi të ardhurat nga paga dhe toka bujqësore, si dhe materiale ndërtimi të marra nga shpërbërja e kooperativës bujqësore në vitin 1991 (tulla, gurë dhe hekur, nga prishja e një magazine). Hekuri përfituar nga një dynym serrë diellore.

Sipas deklaratës së interesave privatë/periodikë vjetorë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar për këtë pasuri: *shtëpi banimi, ndërtuar në vlerën 1.200.000 lekë, ku gjysma është ndërtuar para vitit 1990 dhe pjesa tjetër pas vitit 1990, ndërtuar mbi truallin me sip. 200 m² me të ardhurat familjare, pjesa takuese 25%.*

- Siç vërehet, vlera e banesës objekt kontrolli është deklaruar e ndryshme në dy deklaratimet e mësipërme.

11.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se ASHK-ja Kuçovë ka informuar⁶ Komisionin se Nazmi Troka, me statusin e përfaqësuesit të familjes bujqësore, ka përfituar nga ligji nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”, i ndryshuar (në vijim “ligji nr. 7501/1991”), me AMTP-në (Akti i Marrjes së Tokës në Pronësi) nr. {***}, datë 22.02.1992, truallin me sip. 200 m²

⁶ Shkresë e ASHK-së nr. {***} prot., datë 16.10.2019.

dhe ndërtesë me sip. 99 m², të regjistruar nga subjekti i rivlerësimit më datë 20.12.1996, sipas të dhënave të kartelës së pasurisë, lëshuar më 16.10.2019. Në shkresë nuk përcaktohen katet e ndërtesës.

Komisioni i kërkoi subjektit nëpërmjet pyetësorit nr. 2 të saktësojë dhe të depozitojë prova për burimin e krijimit të kësaj pasurie, vlerën e ndërtimit si dhe kohën e ndërtimit të saj. Në përgjigje, *lidhur me burimin e të ardhurave* që kanë shërbyer për ndërtimin e shtëpisë, subjekti ka shpjeguar se kanë qenë: (i) Të ardhurat nga paga e punës së tij, për periudhën 01.05.1991 – 31.12.2016. Të ardhurat nga paga e tij deri në vitin 2000 kur ka përfunduar tërësisht ky investim, kanë qenë në shumën 2.089.603 lekë. (ii) Të ardhurat e bashkëshortes si mësuese pa shkëputje nga puna që nga data 01.09.1990 e në vazhdim, deri në dhjetor të vitit 2000, në shumën 559.045 lekë (paga bruto). Në këtë periudhë, 2 vite janë leje lindje, të ardhurat e të cilave subjekti nuk i ka gjetur. (iii) Të ardhura nga shitja e produkteve bujqësore në vitet 1992 – 2000 janë mesatarisht 200.000 lekë në vit ose 1.800.000 lekë për këtë periudhë. (iv) Gjithashtu, burim i të ardhurave në ndërtimin e banesës janë edhe nga ndihma që i ka dhënë pjesa tjetër e familjes, pasi janë ndarë nga trangu familjar, si dhe materiale ndërtimi, përfitur nga shpërndarja e pasurisë së ish-kooperativës bujqësore për fshatin {***}.

Lidhur me vlerën e ndërtimit të kësaj pasurie, subjekti shpjegoi se mospërputhja e shifrës 1.200.000 lekë, deklaruar në vitin 2003, me shifrën 3.500.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, ka të bëjë me faktin se në vitin 2003 ka deklaruar koston e ndërtimit të banesës. Ndërsa lidhur me shifrën 3.500.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, është vlera e banesës referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 09.12.1996, “Për miratimin e vlerave mesatare vjetore të apartamentit tip në tregun e lirë dhe vlerës së koeficientit “K””.

Lidhur me kohën e ndërtimit të pasurisë, subjekti ka shpjeguar se banesa është ndërtuar në dy periudha, para vitit 1990 dhe pas vitit 1991, në një kohë kur institucionet dhe ndërmarrjet shtetërore u shpërbënë.

11.4 Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në Komision, paraqiti dokumentacion⁷ për të provuar shpjegimet e tij. Subjekti i rivlerësimit paraqiti dokumentin “situacion punimesh” (pa datë), hartuar nga inxhinier i licencuar, i cili ka paraqitur aktin bazuar në volumet metrike faktike të objektit. Sipas këtij situacioni, në mënyrë të përmbledhur, kostoja totale e ndërtimit, nëse do të ishte realizuar me sipërmarrës firmë ndërtimi dhe do të ishte deklaruar në organet tatimore, do të ishte në shumën 1.869.522 lekë. Në kushtet kur një qytetar i ka kryer punimet me ndihmën e familjarëve, sipas këtij situacioni, kostoja e kësaj banese do të ishte në vlerën 1.284.203 lekë.

⁷ Vërtetim nr. {***} prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë në periudhën 23.10.1993 – 30.06.1998, dhe për periudhën 23.10.1993 – 31.12.1994, nuk disponohen të dhëna; vërtetim nr. {***} prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin vërtetohet se Nazmi Troka ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Berat për periudhën 01.07.1998. – 23.10.2013, në të cilën ka përfitur të ardhura nga paga; vërtetim nr. {***} prot., datë 22.04.2020, lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Berat, me të cilin vërtetohet se Nazmi Troka ka qenë gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Kuçovë, në periudhën 23.10.1993 – 30.06.1998, dhe për shkak të djegies së gjykatës gjatë trazirave të vitit 1997, ka përcaktuar pagat mujore bruto për vitet që s’ka të dhëna, 1993 dhe 1994, sipas VKM-së përkatëse; vërtetim nr. {***} prot., datë 21.04.2020, lëshuar nga ISSH-ja Berat, për pagat e marra nga bashkëshortja e subjektit për periudhën 1994 – 2003; librezë pune e bashkëshortes së subjektit.

11.5 Nga ky dokumentacion i depozituar në Komision prej subjektit të rivlerësimit, nuk mund të verifikohet koha e ndërtimit të banesës. Për pasurinë *shtëpi dykatëshe*, Komisioni konstatoi mospërputhje lidhur me vlerën e shtëpisë së deklaruar në deklaratën *vetting*, krahasuar me DIPP-në e vitit 2003, mungesë dokumentacioni ligjor për ndërtimin e shtëpisë dykatëshe, si dhe mungesë burimesh financiare të ligjshme për ndërtimin e saj në shumën prej (-) 2.327.265 lekësh. Lidhur me këto konstatime, Komisioni i kaloi subjektit të rivlerësimit barrën e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

11.6 Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit të dërguara në Komision më datë 26.10.2021, lidhur me vlerën e shtëpisë së deklaruar në shuma të ndryshme, ashtu si në pyetësorin nr. 2, sqaroi se në deklaratën e interesave private para fillimit të detyrës në vitin 2003, vlera 1.200.000 lekë përfaqëson shumën reale që është shpenzuar prej tij për ndërtimin e shtëpisë dykatëshe. Subjekti ka shpjeguar se vlera e deklaruar në deklaratën *vetting*, në shumën prej 3.500.000 lekësh, përfaqëson çmimin e tregut të ndërtimit të shtëpisë, sa kushtonte kjo pasuri në vitin 2016.

Lidhur me dokumentacionin e regjistrimit të banesës, subjekti ka shpjeguar se është kryer mbi bazën e formularit nr. 1, por në këtë akt nuk ka pasur të pasqyruar asnjë të dhënë tjetër në lidhje me ndërtesën, si numrin e kateve, apo çdo të dhënë tjetër ndërtimore, përveç sipërfaqes së bazës së ndërtimit. Këto të dhëna janë në këtë format për të gjitha fshatrat e administruara nga ASHK Kuçovë. Akti ligjor që u regjistrua banesa në fshat, si për gjithë fermerët, është formulari nr. 1, bazuar në VKM-në nr. 432, datë 14.08.1995, “Për procedurat e regjistrimit të pasurive të paluajtshme në zonën urbane të fshatit”.

Lidhur me diferencën negative të rezultuar në Komision, subjekti i rivlerësimit, ashtu si në pyetësorin nr. 2, sqaroi se si vlerë për ndërtimin e banesës duhet të merret shuma 1.200.000 lekë. Subjekti sqaroi se me ligjin nr. 7501/1991, ka përfituar tokë bujqësore në fshatin {***}, në të cilën ka ushtruar aktivitet bujqësor në vite dhe ka realizuar të ardhura në mënyrë periodike nga ky aktivitet. Subjekti i rivlerësimit shpjegoi se këto të ardhura i ka deklaruar rregullisht në vite në DIPP-të përkatëse, ka paguar taksën e tokës, si dhe ka provuar me dokumentacion nga institucionet shtetërore që ka pasur aktivitet bujqësor. Me këtë arsye, i ka kërkuar Komisionit që në analizën financiare të përfshijë të ardhurat e realizuara nga bujqësia, si të ardhura të ligjshme, të cilat duhet të merren në konsideratë nga Komisioni dhe të përfshihen në analizën financiare. Në lidhje me shpenzimet e jetesës, subjekti ka kërkuar, që në analizën financiare të kryer nga Komisioni, t’i ulen shpenzimet e jetesës, duke pretenduar se për periudhën 1994 – 2000, Komisioni duhet të marrë në konsideratë që subjekti dhe familja e tij jetonin në fshat dhe nuk mund të përlllogariten shpenzime në masën 66% të të ardhurave, pasi shpenzimet e jetesës së tij nuk mund të jenë të njëjta me shpenzimet e shportës së një individi që banon në qytet dhe i blen produktet e shportës.

11.7 Subjekti i rivlerësimit, për të provuar pretendimet e mësipërme, ka depozituar bashkë me prapësimet mbi rezultatet e hetimit, vërtetimin e datës 15.10.2021, lëshuar nga kryeplaku i fshatit {***}, Kuçovë, sipas të cilit sqarohet se familja e Nazmi Trokës jeton në fshatin {***}, Kuçovë, dhe ka pasur të ardhura nga blegtoria deri në vitin 2014. Subjekti i rivlerësimit paraqiti deklaratën

noteriale⁸, datë 15.10.2021, lëshuar nga veterineri, i cili nga viti 1992 deri në vitin 2014 i ka shërbyer familjes bujqësore me kryefamiljar Nazmi Trokën, për mbarështimin e lopëve dhe shpendëve. Gjithashtu, subjekti dorëzoi edhe shkresën nr. {***} prot., datë 11.10.2021, të Bashkisë Kuçovë, me anë të së cilës është përcjellë “Akt-ekspertimi vlerësues i siguar nga toka bujqësore dhe blegtoria për periudhën 1992-2016” për familjen Nazmi Troka. Sipas këtij raporti vlerësimi, subjekti i rivlerësimit ka përfituar të ardhura në shumën totale prej 1.968.100 lekësh nga bujqësia e blegtoria për periudhën 1992-2016.

11.8 Lidhur me vlerën e ndërtimit të banesës, e cila ndërthuret edhe me periudhën e ndërtimit të saj, trupi gjykues i Kolegjit konstatoi se nga hetimi administrativ, rezultoi se në deklarin e parë të vitit 2003, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar në shumën prej 1.200.000 lekësh, ndërsa në deklaratën e pasurisë *vetting*, e ka deklaruar në shumën 3.500.000 lekë, për të cilën sqaron se ka dashur të deklarojë vlerën e tregut në vitin 2016 e jo koston e ndërtimit. Lidhur me *periudhën e ndërtimit*, subjekti i rivlerësimit dha sqarime kontradiktore, pasi në deklaratën *vetting* ka deklaruar shtëpi banimi 2 kate, me sip. 99 m²/kati, filluar ndërtimi para vitit 1991 dhe përfunduar në vitin 2000, bashkë me anekset. Ky deklarin i subjektit për periudhën e ndërtimit të shtëpisë është konfirmuar prej tij edhe në shpjegimet e dhëna në përgjigjet e pyetësorit nr. 2 të Komisionit. Vetëm në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti pretendoi se ndërtimi i banesës ka përfunduar në vitin 1994, të cilin nuk e mbështeti me asnjë provë gjatë hetimit administrativ, për rrjedhojë ky pretendim mbeti në nivel deklarativ. Për sa kohë subjekti i rivlerësimit nuk dorëzoi asnjë provë për të saktësuar periudhën e ndërtimit të banesës, si dhe në kushtet kur subjekti ka mospërputhje në shpjegimet e tij në Komision dhe deklarimet në ILDKPKI, trupi gjykues i Kolegjit e vlerësoi të drejtë vendimmarrjen e Komisionit për të konsideruar si periudhë të ndërtimit të banesës vitet 1990-2000, sipas deklarimit të subjektit të rivlerësimit në deklaratën *vetting*. Komisioni në një vlerësim objektiv, për efekt të llogaritjes së koston së ndërtimit të shtëpisë dykatëshe, ka përlllogaritur koston e ndërtimit referuar çmimeve sipas Entit Kombëtar të Banesave, ku referuar këtyre çmimeve, për periudhën 1994 – 2000, ndërtimi i shtëpisë rezulton të ketë kushtuar në shumën 3.105.538 lekë. Kjo vlerë është përfshirë në tabelën e analizës financiare të Komisionit, si kostoja e ndërtimit të shtëpisë dykatëshe.

11.9 Duke qenë se subjekti i rivlerësimit nuk ka paraqitur dokumentacion provues lidhur me vlerën e shpenzuar për ndërtimin e banesës, dhe nga ana tjetër deklarimet e tij për shpenzimet e këtij ndërtimi janë përcaktuar në vlera të ndryshme, referuar deklarimit të parë të pasurisë në vitin 2003 dhe në deklaratën *vetting*, trupi gjykues i Kolegjit iu referua të dhënave që përmbajnë vendimet e Këshillit të Ministrave për koston e ndërtimit, të gjendura në faqen zyrtare në internet të Entit Kombëtar të Banesave. Bazuar në të dhënat e publikuara në këtë faqe⁹, koston e ndërtimit nëpër qytetet e Shqipërisë rezultojnë të përcaktuara me VKM-të përkatëse që prej vitit 1995 e në vazhdim. Referuar Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 815, datë 09.12.1996, “Për miratimin e vleftave mesatare vjetore të apartamenteve tip në tregun e lirë dhe te vleftës se koeficientit “K””, kostoja mesatare e ndërtimit për vitin 1995, për sipërfaqe shfrytëzimi ka qenë në vlerën 16.357

⁸ Deklaratë noteriale nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 15.10.2021.

⁹ <https://ekb.gov.al/kostot-e-ndertimit-viti-1995/>

lekë/m², ndërsa për sipërfaqe ndërtimi ka qenë në vlerën 12.785 lekë/m². Komisioni ka konsideruar si vlerë për m² koston mesatare për sipërfaqe shfrytëzimi, edhe pse nuk e kemi të dhënë në dokumentacionin e administruar në dosje këtë sipërfaqe, gjë që nuk është kundërshtuar në ankim nga subjekti i rivlerësimit. Kjo mënyrë përlllogaritjeje e vlerës së ndërtimit nuk përputhet me jurisprudencën¹⁰ e Kolegjit, ndaj trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se sipërfaqja e ndërtuar duhej shumëzuar me koston mesatare të ndërtimit dhe jo me koston e shfrytëzimit, bazuar në përcaktimet ndër vite të udhëzimeve të Këshillit të Ministrave “Për miratimin e koston mesatare të ndërtimit të banesave, nga Enti Kombëtar i Banesave”, me qëllim përcaktimin e saktë dhe të drejtë të vlerës së ndërtimit. Edhe në variantin nëse përlllogaritja kryhet duke shumëzuar sipërfaqen e ndërtuar me koston mesatare të ndërtimit (12.785 lekë/m²), nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, subjekti i rivlerësimit sërish rezulton me diferencë të konsiderueshme negative.

11.10 Në vijim të sa më sipër, Kolegji vlerësoi se, në kushtet kur mbeti i paprovuar pretendimi i subjektit të rivlerësimit për ndërtimin e banesës në periudhën 1990-1994, konsideroi të drejtë vlerësimin e Komisionit, i cili përlllogariti si periudhë ndërtimi vitet 1990-2000. Trupi gjykues çmoi që kosto mesatare për m² të pasurisë objekt kontrolli, të konsiderojë atë të përcaktuar në VKM-në e vitit 1995, kjo për të balancuar shpenzimet që do të përlllogariten në funksion të kontrollit që kryen Kolegji ndaj analizës financiare të Komisionit gjatë periudhës 10-vjeçare të ndërtimit të shtëpisë dykatëshe. Në përfundim të sa më sipër, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, duke mos përfshirë në këtë analizë të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të krijuara nga toka bujqësore (trajtuar më gjerësisht në shkakun e apartamentit me sip. 64 m² më poshtë në këtë vendim), rezultoi se subjekti i rivlerësimit nuk kishte mundësi të përballonte shpenzimet e jetesës dhe të ndërtonte banesën në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Kuçovë, për diferencën negative në shumën prej (-) 955.369 lekësh, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, shkronja “b” e ligjit nr. 84/2016.

- 12.** Lidhur me pasurinë *apartament banimi me sip. 64 m²*, ndodhur në rr. “{***}”, Tiranë, subjekti i rivlerësimit pretendoi se huadhënësi A. M. ka pasur burime financiare të ligjshme për t’i dhënë hua subjektit shumën prej 25.000 eurosh për blerjen e apartamentit objekt kontrolli. Subjekti pretendon se llogaria bankare e kumatit është shtuar gradualisht nga viti 2000 deri në vitin 2014. Gjithashtu, subjekti sqaron se i ka vënë në dispozicion Komisionit dokumentacion për të ardhurat e z. M., të cilat kanë burim shitjen e një apartamenti në pronësi të tij në vitin 2006, në shumën 10,000 euro, dokumentacion për shumën prej 3.700.000 lekësh letra me vlerë, të përfituar nga dhurimi i shtetasit Q. M., si dhe për shumën prej 1.000.000 lekësh, të dhuruar A. M. nga Q. M., të përfituar si ish i burgosur politik. Subjekti i rivlerësimit pretendon se huadhënësi ka pasur mundësi për t’i dhënë huanë subjektit të rivlerësimit, pasi ka shitur një apartament në shumën 10.000 USD. Gjithashtu, subjekti pretendon se nuk e ka detyrim të kryejë analizën financiare të kumatit të tij, që nga viti 2000, sepse ky i fundit i ka pasur paratë

¹⁰ Vendimet e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit nr. 15/2019 (JR), datë 17.07.2019; nr. 6/2022 (JR), datë 17.03.2022.

në sistemin bankar dhe verifikimin e burimit të tyre e ka kryer banka në momentin e depozitimit.

12.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë pasuri: *Nuk u provuan bindshëm të ardhurat që kanë shërbyer për blerjen e pasurisë, në përputhje me pikën 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Për rrjedhojë, në kuptim të kësaj dispozite kushtetuese dhe neneve 30 dhe 33 të ligjit nr. 84/2016, subjekti i rivlerësimit ka rezultuar të jetë në kushtet e mungesës së burimeve të ligjshme për të justifikuar blerjen e apartamentit në Tiranë. Subjekti rezultoi në mungesë të burimeve financiare të ligjshme për blerjen e apartamentit, në shumën (-) 1.892.478 lekë.*

12.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në deklaratën vetting, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Apartament banimi 1+1, rruga “{***}”, kompleksi {***}, sipërfaqe e përgjithshme 64 m², sipërfaqe funksionale 57 m². Prona shlyer në vlerën 4.314.361 lekë ose 24970 euro, shlyer nga depozita bankare në Raiffeisen Bank, datë 31.10.2014. Vlera prej 25.000 eurosh, hua nga A. M.. Transaksioni bankar i datës 27.10.2014 nga BKT. Vlera prej 5.700 eurosh, nga depozita bankare B. T. tek Intesa SanPaolo Bank, transaksion i datës 31.10.2014. Vlera prej 11.330 eurosh, shlyer nga gjendja cash me të ardhurat e siguruara gjatë vitit 2014.*

Në rubrikën “Detyrime”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Detyrim sipas “Kontratë huaje” për blerje apartamenti (1+1) në Tiranë, më datë 27.10.2014. Për transaksionin e kryer më datë 27.10.2014 nga Banka Kombëtare, marrë hua nga A. M., nëpërmjet Raiffeisen Bank, te Nazmi Troka. Kohëzgjatja e shlyerjes së kontratës deri më datë 31.12.2019. Detyrimi është ndaj huadhënësit A. M.. Detyrimi i mbetur 13.000 euro.*

Në DIPP-në e vitit 2014, subjekti i rivlerësimit e ka deklaruar: *Shtuar apartament banimi 1+1, rruga “{***}”, 64 m², vlera e apartamentit është shlyer me një pjesë nga depozitat bankare dhe një pjesë e marrë hua, si dhe nga kursimet cash, vlera 67.000 euro.*

Në rubrikën “Detyrime”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar: *Kontratë huaje noteriale, për blerje apartamenti (1+1) në Tiranë, më datë 27.10.2014, në shumën 25.000 euro. Transaksion i kryer më datë 27.10.2014 nga Banka Kombëtare Tregtare, marrë nga A. M., nëpërmjet Raiffeisen Bank, te Nazmi Troka. Kohëzgjatja e shlyerjes së kontratës deri më datë 31.12.2019.*

12.3 Nga dokumentacioni i administruar në dosjen e Komisionit, rezulton se AShK-ja Tiranë, OShEE-ja dhe UKT-ja nuk kanë konfirmuar pasuri, kontratë të furnizimit me energji elektrike dhe të furnizimit me ujë në emër të subjektit të rivlerësimit. Nga dokumentacioni i depozituar nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, ka rezultuar se apartamenti me sip. 64 m², me kontratën e porosisë nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 25.02.2013, ishte porositur nga z. D. H., dhe palë sipërmarrëse shoqërinë “{***}” ShPK, për çmimin 57.600 euro. Më pas, me aktin noterial nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., datë 31.10.2014, është nënshkruar akti për zgjidhjen vullnetare të kontratës së porosisë, datë 25.2.2013, e lidhur ndërmjet palëve D. H., Nazmi Troka dhe shoqërisë “{***}” ShPK, sipas së cilës shtetasi D. H. heq dorë nga kontrata e porosisë e datës 25.02.2013, me të cilën ka prenotuar apartamentin me sip. 64 m², në rrugën “{***}”, Tiranë, me vlerë 57.600 euro te shoqëria “{***}” ShPK, dhe këtë apartament deklarohet se ia ka shitur subjektit të rivlerësimit me të njëjtin çmim të apartamentit, si dhe një shtesë prej 9.400 eurosh për punimet e kryera, duke arritur vlerën totale 67.000 euro, e cila është likuiduar totalisht nga shtetasi Nazmi

Troka, prej të cilave 57.000 euro deklarohet se kanë kaluar nëpërmjet llogarive bankare, ndërsa pjesa tjetër prej 9400 eurosh i është dhënë *cash* nga subjekti i rivlerësimit. Në këtë kontratë, është parashikuar se kontrata përfundimtare e shitjes do të lidhet ndërmjet shoqërisë “{***}” ShPK dhe subjektit të rivlerësimit.

12.4 Më datë 27.10.2014, subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e huamarrësit, ka nënshkruar një kontratë huadhënieje me nr. {***} rep., dhe nr. {***} kol., me z. A. M., huadhënës i shumë 25.000 euro, pa interes dhe kthimi do realizohej me këste çdo fundvit, në shumën 5.000 euro, deri më datë 31.12.2019. Sipas parashikimeve të kontratës, këtë shumë huamarrësi ia kalon huadhënësit nëpërmjet llogarisë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare më datë 27.10.2014. Në kontratë, është parashikuar se huadhënësi nuk kërkon garanci pasurore për kthimin e kësaj shume për shkak të marrëdhënieve familjare që ata kanë (baxhanakë). Bashkëlidhur kontratës, rezulton e dokumentuar transferata bankare në BKT, datë 27.10.2014, nga huadhënësi, me përshkrimin: *Kalim për blerje apartamenti*, në Raiffeisen Bank, në favor të z. Nazmi Troka, në vlerën 25.000 euro.

12.5 Lidhur me huanë në shumën 25.000 euro, marrë hua z. M., Komisioni analizoi burimet e ligjshme të huadhënësit që kanë shërbyer për dhënien e kësaj huaje, sipas transaksionit bankar të datës 27.10.2014, nga BKT-ja. I pyetur nga Komisioni në pyetësonin nr. 2 për dokumentacionin që provon mundësinë e huadhënësit për dhënien e huasë me burime të ligjshme, subjekti ka sqaruar se për këtë arsye, ka lidhur edhe kontratën noteriale të huasë, datë 27.10.2014, me huadhënësin A. M.. Ai që nga viti 1992, ka emigruar në Greqi dhe pas vitit 1998, jeton si rezident familjarisht në qytetin e {***}, Greqi. A. M. ka qenë në marrëdhënie pune rregullisht dhe ka punuar dhe punon kryesisht në ndërtim në punë formale, pa munguar dhe puna informale. Jo vetëm ai, por edhe familjarët e tij kanë qenë në marrëdhënie pune të rregullta, por dhe informale. Bashkë me përgjigjet e pyetësorit, subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion¹¹ për të provuar shpjegimet e tij.

12.6 Komisioni analizoi mundësinë financiare të huadhënësit për dhënien e huasë subjektit të rivlerësimit, nga analiza e të cilit rezultoi se ai dhe familja e tij nuk kanë pasur burime financiare të ligjshme për dhënien e huasë në shumën 25.000 euro, pasi rezultojnë me balancë negative në shumën (-) 16.285.981¹² lekë. Komisioni hetoi lidhur me ndonjë rast të mundshëm konflikti interesi, duke kërkuar informacion në Gjykatën e Apelit Vlorë¹³ dhe në Gjykatën e Rrethit

¹¹ - Dokument nga zyra tatimore e të ardhurave në Patra, datë 23.12.2019, sipas të cilit A. M., për periudhën 2002-2015, ka përfutuar të ardhura në vlerën 161.682,44 euro. Dokumenti është në gjuhën greke, i përkthyer në shqip nga përkthyes zyrtar.

- Shkresë, datë 23.12.2019, nga sigurimet shoqërore në Greqi, me të dhëna për djalin e huadhënësit për periudhën 2007-2014, sipas së cilës djali i z. A. M. ka përfutuar të ardhura në shumën rreth 24.000 euro.

- Kontratë çelje depozite në BKT, në emër të A. M., në datën 18.01.2013, në shumën 7.600.000 lekë (nga kjo llogari i ka kaluar shumën 25.000 euro subjektit të rivlerësimit).

¹² Komisioni në këtë analizë ka përfshirë si shpenzime edhe blerjet e pasurive dhe depozitën në BKT të huadhënësit, ndryshe nga standardi i Kolegjit, sipas të cilit llogariten të ardhura minus shpenzime.

¹³ Shkresë nr. {***} prot., datë 27.09.2021.

Gjyqësor Berat¹⁴ për procese gjyqësore të zhvilluara nga subjekti me palë A., E. dhe A. M., të cilat kanë konfirmuar se pranë këtyre institucioneve, këta shtetas nuk kanë qenë palë në procese gjyqësore.

Komisioni konstatoi se huadhënësi nuk ka pasur burime të ligjshme nga aktiviteti i tij në Greqi për të përballuar shpenzimet jetike të tij dhe, në të njëjtën kohë, për t'i dhënë huanë subjektit të rivlerësimit, si dhe subjekti rezulton me pamjaftueshmëri burimesh të ligjshme për blerjen e pasurisë, në shumën 4.057.508 lekë. Për këtë arsye, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

12.7 Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit dorëzoi në Komision prapësimet mbi rezultatet e hetimit, në të cilat shpjegoi se E. dhe A. M. (motra e bashkëshortes dhe bashkëshorti i saj) i kanë vënë në dispozicion pasqyrën e llogarisë bankare në euro, të marrë nga Banka Kombëtare e Greqisë, ku pasqyrohen saktë transaksionet që janë kryer në këtë llogari bankare (depozitat dhe tërheqjet), për periudhën 2000 – 2014. Në këtë dokument, konstatohet se kjo llogari është mbushur gradualisht çdo vit. Në datën 11.07.2011, këta persona kanë tërhequr shumën 35.000 euro dhe më 08.08.2011, kanë tërhequr shumën 20.000 euro, që sikurse i kanë shpjeguar, i kanë tërhequr për shkak të pasigurisë që u krijua në atë periudhë në bankat greke. Subjekti ka sqaruar se është pikërisht kjo shumë monetare e depozituar vit pas viti, që vërteton se z. M. ka pasur mundësi financiare për të vendosur depozita bankare duke i tërhequr në vitin 2011, dhe i ka rivendosur në BKT, në datën 18.01.2013. Subjekti ka shpjeguar se shtëpia e banimit që shtetasi A. M. ka blerë në vitin 2004, në Berat, është mbuluar me shumën që ka tërhequr në vitin 2003, në vlerën 40.000 euro.

12.8 Bashkëngjitur prapësimeve mbi rezultatet e hetimit, subjekti i rivlerësimit ka paraqitur urdhërzhirimit të bankës Credins për A. M. në shumën 1.000.000 lekë, në të cilin specifikohet: *Dëmshpërblim për ish të dënuarit [...], datë 03.04.2017*; mandat tërheqjeje bankare nga A. M. në shumën 7.092 euro në datën 02.07.2013 pas këmbimit të shumës 1.000.000 lekë nga llogaria në Credins Bank në po të njëjtën datë. Subjekti i rivlerësimit sqaroi se huadhënësi ka tërhequr nga Credins Bank shumën 1.000.000 lekë, si këst dëmshpërblimi për xhaxhain e tij Q. M., si ish i dënuar i regjimit komunist, ku A. M. është trashëgimtar i vetëm i z. Q. M.. Nga ky mandat bankar, nuk provohet pretendimi i subjektit të rivlerësimit, pasi në të është vendosur shënimi: *Tërheqje cash nga A. M., nga këmbimi i bërë nga lekë në euro*, prej të cilit nuk specifikohet asgjë nga ato që pretendon subjekti i rivlerësimit, për më tepër përfitimi nga xhaxhai sipas mandatit bankar më sipër, është përfituar në vitin 2017, ndaj ky pretendim i subjektit të rivlerësimit nuk gjendet i bazuar.

Subjekti i rivlerësimit ka dorëzuar në Komision, kontratë dhurimi me nr. {***}, datë 13.01.1995, sipas së cilës Q. M. i ka dhuruar nipit të tij A. M. të ardhurat e përfituara si i burgosur politik (nuk është specifikuar shuma), si dhe shumën 3.700.000 lekë letra me vlerë, që ndodheshin në Bankën

¹⁴ Shkresë nr. {***} prot., datë 30.09.2021.

e Kursimeve. Dhuruesi ka sqaruar në kontratë se këtë dhurim e bën pasi A. M. i shërben dhe e respekton si babain e tij.

Subjekti paraqiti në Komision bashkë me prapësimet, edhe kontratën e shitjes nr. {***} të datës 23.01.1996, në të cilën parashikohet se z. M. shet një apartament në shumën 10.000 USD.

12.9 Neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, përcakton në mënyrë specifike se cilat marrëdhënie përfshihen në fushën e interesit pasuror, ku përfshihet dhe marrëdhënia e huamarrjes së subjektit të rivlerësimit me A. M.. Duke qenë se ekziston një kontratë huadhënieje, si dhe huaja ka kaluar nëpërmjet llogarive bankare, konfirmohet marrëdhënia e huasë ndërmjet subjektit të rivlerësimit dhe z. M., ndaj gjendemi në parashikimet e nenit 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, ku subjekti i rivlerësimit, për efekt të procesit të rivlerësimit, ka detyrimin të provojë burimin e ligjshëm të pasurisë së personit tjetër të lidhur, që ka shërbyer për dhënien e huasë në shumën 25.000 euro.

Trupi gjykues i Kolegjit konstaton nga dokumentacioni i administruar në dosje, se subjekti i rivlerësimit ka marrë nëpërmjet sistemit bankar, shumën prej 25.000 eurosh nga A. M., dhe ka shlyer po nëpërmjet sistemit bankar, shumën prej 19.100 eurosh. Nga të dhënat e llogarisë bankare në Greqi, vënë në dispozicion të Komisionit nga z. M., duket se janë kryer veprime të ndryshme në forma investimi, të kursimeve të tij vit pas viti. Në Kolegj, u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit, për të parë mundësinë e krijimit të kursimeve nga z. M., prej të cilave i ka dhënë hua shumën 25.000 euro subjektit të rivlerësimit për blerjen e apartamentit objekt kontrolli, duke përlllogaritur të ardhura minus shpenzime për familjen e z. A. M., për periudhën 2002-2014 (nga momenti që ka të dhëna për llogarinë bankare në Bankën Kombëtare Tregtare në Greqi, nëpërmjet së cilës është xhiruar shuma e dhënë hua, deri në dhënien e huasë në vitin 2014).

12.10 Gjatë kontrollit që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, u verifikua llogaria bankare në Bankën Kombëtare të Greqisë e z. M., si pjesë e dokumentacionit të dorëzuar nga subjekti i rivlerësimit në kuadër të detyrimit që i lind nga neni 32, pika 4 e ligjit nr. 84/2016, nga e cila rezultoi se përmban të dhëna që në datën 20.01.2000, në shumën 3.000.389 drahami greke. Llogaria ka pësuar ndryshime të shumta në vazhdimësi, si depozitime, investime në obligacione, kreditime nga interesat, tërheqje e të tjera, si dhe ka pasur gjendje kreditore vit pas viti.

Duke mos pasur në dosje dokumentacion të detajuar të përbërjes familjare të z. M., në Kolegj u përlllogaritën shpenzimet e jetesës për familjen e tij me dy variante, duke konsideruar familjen e tij me tre persona, si dhe me katër persona, shpenzimet e jetesës së të cilave për periudhën 2002-2014 në Greqi, kanë rezultuar respektivisht në shumën 117.577 euro dhe 223.974 euro.

12.11 Në vijim të sa më sipër, në Kolegj është analizuar vetëm diferenca mes të ardhurave të përfituara nga puna, sipas dokumentacionit të të ardhurave që i përket A. M. dhe djalit të tij, me shpenzimet e jetesës për periudhën 2002-2014. Në këtë analizë nuk janë përfshirë të ardhurat që subjekti pretendon se janë përfituar nga z. A. M. si dëmshpërblim për ish të përndjekurit politikë, në shumën 1.000.000 lekë në vitin 2017, pasi ato janë përfituar pas dhënies së huasë (në vitin 2014) subjektit të rivlerësimit.

Në lidhje me pretendimin e subjekti të rivlerësimit se z. M. ka përfituar 10.000 USD nga shitja e një apartamenti në pronësi të tij në vitin 1996, kjo vlerë nuk u konsiderua në analizën ekonomike,

duke qenë se sipas dokumentacionit¹⁵ të administruar në dosje, rezulton se kjo banesë është shitur nga z. M. në datën 23.01.1996 (subjekti në ankim ka shënuar datën 23.01.2006), për më tepër analiza e personit tjetër të lidhur është kryer sipas jurisprudencës së Kolegjit sipas formulës të ardhura minus shpenzime, pa përfshirë transaksionet e shitblerjeve të pasurive apo depozita bankare. Gjithashtu, nga kontrata e shitjes së cituar më sipër, rezulton se këtë apartament, z. M. e kishte në bashkëpronësi me vëllain e tij.

12.12 Lidhur me pretendimin e subjektit të rivlerësimit se analiza e personit tjetër të lidhur (z. M.) nuk duhet të jetë e shtrirë aq gjatë në kohë, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson se vetë subjekti i rivlerësimit ka sjellë dokumentacion për të ardhurat e A. M. për periudhën 2002-2014. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se llogaria e personit tjetër të lidhur në Bankën Kombëtare të Greqisë ka informacion që nga viti 2000 deri në vitin 2012. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në datën 31.12.2010, llogaria ka pasur gjendje 55.000 euro, të cilat janë tërhequr nga personi tjetër i lidhur në vitin 2011 dhe nuk kemi informacion për destinacionin e kësaj shume. Në datën 17.01.2013, E. dhe A. M. kanë hapur depozitë në BKT, në shumën 7.600.000 lekë, ku sipas sqarimeve të subjektit të rivlerësimit në prapësimet e rezultateve të hetimit, z. M. i ka tërhequr në vitin 2011 dhe i ka rivendosur në BKT, në datën 17.01.2013, dhe i ka dhënë subjektit më datë 27.10.2014, huanë prej 25.000 eurosh. Kolegji vlerëson se nga viti 2011 deri në vitin 2013 janë gati dy vite, distanca e të cilëve, si dhe mungesa e dokumentacionit, pamundëson kontrollin e Kolegjit për të verifikuar se çfarë destinacioni ka pasur shuma prej 55.000 eurosh, e tërhequr në vitin 2011 nga Banka Kombëtare e Greqisë, ndaj nuk mund të konkludohet se depozita në BKT, në shumën 7.600.000 lekë, e ka burimin nga llogaria prej së cilës është tërhequr shuma 55.000 euro. Gjithashtu, pasqyrat financiare të A. M. në Bankën Kombëtare të Greqisë, të depozituara në Komision nga subjekti i rivlerësimit, kanë të dhëna që nga viti 2000, ndaj është vështirë të fragmentohet dhe shkurtohet periudha e kontrollit të personit tjetër të lidhur. Me këtë logjikë, pavarësisht se duket disproporcional kontrolli i ushtruar nga Komisioni ndaj personit tjetër të lidhur, periudha e të cilit është e shtrirë në kohë pothuajse aq sa e subjektit të rivlerësimit, në kushtet në të cilat gjendet dokumentacioni i A. M., duket se kontrolli i ushtruar nga Komisioni për atë periudhë, gjendet i bazuar.

Në përfundim të kontrollit të analizës së kryer nga Komisioni, duke mos pasur qartësi se prej sa personash përbëhej familja e huadhënësit dhe se çfarë pune kanë bërë me saktësi ata, të dhëna të cilat duhet t'i qartësonte subjekti i rivlerësimit në kuadër të përmbushjes së detyrimit për të provuar mundësinë reale të huadhënësit për t'i dhënë huanë subjektit në vitin 2014, rezultoi se z. M. nuk kishte mundësi financiare të ligjshme të përballonte shpenzimet, për diferencën negative në shumën prej (-) 1.644.198 lekësh, si rrjedhojë nuk kishte mundësi t'i jepte huanë në shumën 25.000 euro subjektit të rivlerësimit, ndaj kjo shumë nuk u përllogarit si burim i ligjshëm për blerjen e apartamentit nga subjekti i rivlerësimit.

12.13 *Lidhur me të ardhurat nga prodhimet bujqësore e pemëtaria*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar në deklaratat periodike, vit pas viti, të ardhura nga prodhimet e pemëtarisë. Në vitin

¹⁵ Kontratë shitje nr. {***}, datë 23.08.1996.

2016, subjekti i rivlerësimit, përveç të ardhurave të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore, ka deklaruar edhe licencimin e këtij aktiviteti nga Drejtoria Rajonale Tatimore Berat, duke u pajisur me numër të identifikueshëm tatimor (NIPT). Në deklaratën *vetting*, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar nga shitja e produkteve fruta e perime, të siguruara nga toka bujqësore në fshatin {***}, Kuçovë, për periudhën 1992-2016, të ardhura në total prej 7.000.000 lekësh. Nga verifikimi i shumave të deklaruara në DIPP-të vjetore, për periudhën 2003 – 2016, ka rezultuar se subjekti ka deklaruar shumën totale prej 7.152.000 lekësh. Lidhur me këtë mospërputhje, si dhe me aktivitetin bujqësor dhe të ardhurat e gjeneruara prej këtij aktiviteti, subjektit i është kërkuar nga Komisioni që të depozitohet dokumente për të provuar të ardhurat e gjeneruara nga shitja e produkteve bujqësore, si dhe të japë shpjegime kush ka qenë i përfshirë në punët e bujqësisë. Për këto të ardhura, subjektit i është kërkuar t'i provojë me dokumentacion që nga viti 1992, duke specifikuar shitjet në vlerë dhe në sasi të produkteve; kostot për ambalazhimin e produkteve, transportin dhe shpenzime të tjera për këtë aktivitet, si dhe informacion të detajuar në lidhje me këto të ardhura, ku të provohet se janë paguar detyrimet tatimore në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës.

12.14 Subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, lidhur me pyetjen se kush është përfshirë në punët e bujqësisë, sqaroi se ka jetuar dhe vazhdon të jetojë familjarisht në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}, Bashkia Kuçovë, kryesisht gjatë gjithë kohës, ai dhe familja e tij në fundjavë dhe pasditeve janë marrë edhe me kujdesin e punëve për të kultivuar dhe shitur prodhimet nga toka bujqësore. Lidhur me pagimin e tatimeve mbi të ardhurat e siguruara nga shitja e prodhimeve bujqësore, sqaroi se fermeri paguan vetëm taksën për tokën, të cilën shpjegoi se e ka paguar rregullisht dhe kjo provohet me vërtetimin e lëshuar nga Njësia Administrative {***}, ku cilësohet se i ka shlyer të gjitha detyrimet. Subjekti sqaroi se nga viti 1992 e në vazhdim, e kanë shfrytëzuar të gjithë tokën bujqësore prej 8 dynymësh me kultivimin e perimeve, por kryesisht pemëtari të llojit pjeshkë, kumbulla dhe agrume. Prodhimet janë shitur pa faturë, sipas kërkesave të personave të tretë (tregtarë nga Berati, Vlora dhe Tirana). Gjithashtu, sqaroi se fermerët regjistrohen në organet tatimore rajonale vetëm për t'u pajisur me NIPT, pa përgjegjësi tatimore. Subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, në Komision, paraqiti dokumentacion¹⁶ për të provuar shpjegimet e tij.

¹⁶ - Vërtetim nr. {***} prot., datë 14.04.2020, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, në të cilin sqarohet se z. Nazmi Troka është banor në fshatin {***}, Njësia Administrative {***}/Kuçovë, si dhe ka shlyer detyrimet tatimore pranë njësisë për vitin 2019.

- Vërtetim nr. {***} prot., datë 14.04.2020, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, në të cilin sqarohet se në bazë të regjistrimit nr. {***} të rishpërndarjes së ish-kooperativës, fshati {***}, z. B. T. ka përfituar tokë.

- Vërtetim nr. {***} prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, Zyra e Tatim-Taksave, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka shlyer detyrimet tatimore ndaj Njësisë Administrative {***}.

- Vërtetim nr. {***} prot., datë 21.10.2016, lëshuar nga Bashkia Kuçovë, Zyra e Kadastrës, me të cilin vërtetohet se z. Nazmi Troka ka në pronësi tokë bujqësore, përfituar nga ligji nr. 7501/1991, me sip. 8.000 m², ndodhur në fshatin {***}. Kjo tokë shfrytëzohet nga pronari Nazmi Troka, që nga viti 1991 e në vazhdim, dhe në të kultivon pemë frutore nga të cilat siguron të ardhura.

- Certifikatë regjistrimi të personit të tatueshëm, për fermer, në emër të subjektit të rivlerësimit, me datë lëshimi 15.11.2016.

12.15 Trupi gjykues i Kolegjit konstaton se subjekti i rivlerësimit ka paraqitur në Komision një raport vlerësimi, datë 20.04.2021, të ekspertës L. B., me kërkesë të subjektit të rivlerësimit. Sipas këtij akti, rezulton se në tokën bujqësore në pronësi të tij, janë kultivuar pemë të ndryshme frutore, të cilat kanë prodhuar kumbulla, fiq, mollë, lajthi, hurma, shegë, rrush, pjeshkë, mandarina etj. Ekspertja ka kryer një përlllogaritje të mundësisë së prodhimit për secilën pemë, duke u bazuar në shpjegimet e subjektit të rivlerësimit, pamjet e ortofotove nga *google earth*, studimeve të ndryshme statistikore dhe kërkimeve në internet. Sipas raportit të vlerësimit, të ardhurat e krijuara nga subjekti i rivlerësimit në total, për periudhën 1996 – 2016, janë afërsisht në shumën 12.965.794 lekë. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se kjo shumë nuk përputhet me atë që ka deklaruar subjekti i rivlerësimit në deklaratën *vetting*, për periudhën 1992 – 2016, në shumën 7.000.000 lekë, si dhe deklaratimet në deklaratat periodike vjetore ndër vite.

12.16 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se akti i ekspertimit i referohet një sasi të ardhurash sa dyfishi i atyre të deklaruara nga subjekti i rivlerësimit, të cilat janë kërkuar nga ky i fundit për t'u përlllogaritur nga eksperti. Në faqen 14 të raportit të vlerësimit, është cituar nga ekspertja: *Këto pemë janë mbjellë menjëherë sapo është marrë toka bujqësore në pronësi, pra pas vitit 1992. Sipas kësaj të dhëne, prodhimi, kryesisht i pjeshkave, fillon në vitin e 3-4, pra prodhimet fillojnë nga viti 1995-1996 e në vazhdim.* Periudha e cila u është nënshtruar përlllogaritjeve në raportin e vlerësimit, përfshin vitet nga 1992-2016, kohë relativisht e largët dhe e vlerësuar mbi bazën e deklaratimeve të subjektit të rivlerësimit për llojin dhe sasinë e të mbjellave në këtë tokë bujqësore, mbështetur mbi hipoteza për mundësinë e prodhimit të produkteve të ndryshme bujqësore nga toka, situatë e cila të krijon bindjen se është realizuar nga eksperti në këtë mënyrë, për të favorizuar subjektin e rivlerësimit. Në këtë raport vlerësimi, ekspertja ka nxjerrë përfundime për të ardhurat e përfituara nga bujqësia në një masë shumë më të madhe se sa ajo e deklaruar nga vetë subjekti i rivlerësimit. Si rrjedhojë, trupi gjykues vlerëson se raporti i vlerësimit duket se nuk provon llojshmërinë dhe sasinë reale të produkteve të prodhuara ndër vite, pasi është hartuar mbi baza hipotetike, me kërkesë të subjektit të rivlerësimit dhe mbi orientimin e tij e, si i tillë, nuk ka vlerë provuese për sasinë e të ardhurave të krijuara nga pemëtaria në masën e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit.

12.17 Në vijim të sa më sipër, subjekti nuk arriti të provojë realizimin e të ardhurave të deklaruara në deklaratat periodike 2003-2016, si të përfituara nga bujqësia e pemëtaria. U provua se subjekti i rivlerësimit ka përfituar tokë nga ligji 7501/1991, si dhe se ka paguar rregullisht taksën e tokës e të ndërtesës. Gjithashtu, rezultoi e provuar se subjekti i rivlerësimit është regjistruar në organet tatimore për t'u përfshirë në skemën e rimbursimit të TVSh-së për fermerin, nëpërmjet së cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSh-së duhet të deklarorin shitjet e tyre. Subjekti dorëzoi

- *Faturë tatimore, lëshuar nga Nazmi Troka, e datës 24.02.2018, për shitjen e 8.500 kg mandarina, në shumën totale 510.000 lekë.*

- *Nxjerrje llogarie bankare pranë BKT, ku rezulton pagesa e likuidimit të një fature nga subjekti tregtar “{***}” ShPK, në shumën 270.000 lekë, në datën 19.09.2019.*

- *Deklaratë, datë 20.04.2020, (shkresë e thjeshtë) e S. D., i cili ushtronte aktivitet si person fizik, tregtim të artikujve të ndryshëm import-eksport, për artikujt fruta-perime, dhe deklarorin se subjekti i rivlerësimit e ka furnizuar me fruta perime që prej vitit 1996 e deri në momentin e nënshkrimit të kësaj deklaratë.*

faturë tatimore, lëshuar nga vetë ai, të datës 24.02.2018, për shitjen e 8.500 kg mandarina në shumën totale 510.000 lekë, fakte këto të cilat nuk provojnë krijimin e të ardhurave në sasinë e pretenduar nga subjekti i rivlerësimit. Si rrjedhojë, të ardhurat nga bujqësia e pemëtaria, të deklaruara në vijimësi nga subjekti, në të gjitha deklaratat periodike në ILDKPKI, nuk u mbështetën me dokumentacion provues, duke mbetur në nivel deklarativ. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka mospërputhje të sasisë së të ardhurave të deklaruara si të përfituara nga kjo veprimtari në deklaratën *vetting* (7.000.000 lekë), me totalin e të ardhurave të deklaruara ndër vite (7.152.000 lekë) në ILDKPKI, duke e bërë të pabesueshëm faktin e përfitimit të kësaj sasive të të ardhurave, ndaj për këto arsye, trupi gjykues i Kolegjit vlerëson të drejtë konkluzionin e Komisionit për të mos i përfshirë të ardhurat e deklaruara si të përfituara nga toka bujqësore në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit.

12.18 Në përmbyllje të analizës për pasurinë objekt shqyrtimi, apartament banimi me sip. 64 m², ndodhur në rrugën “{***}”, Tiranë, rezultoi e provuar huaja e marrë në shumën 25.000 euro, e dhënë nga z. M., e cila ishte dakordësuar me kontratë noteriale dhe që ka kaluar nëpërmjet llogarive bankare të palëve kontraktuese. Nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se personi tjetër i lidhur nuk mund të përballonte shpenzimet për diferencën negative në shumën (-) 1.644.198 lekë, si rrjedhojë nuk kishte mundësi t’i jepte huanë në shumën 25.000 euro subjektit të rivlerësimit, për t’i shërbyer si burim për blerjen e apartamentit objekt kontrolli. Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit nuk arriti të provojë me dokumentacion ligjor të ardhurat e përfituara nga bujqësia e pemëtaria, duke mbetur në nivel deklarativ pretendimet e tij për sasinë e të ardhurave të pretenduara si të përfituara nga toka bujqësore e të deklaruara në deklaratën *vetting*, si dhe ato periodike. Si rrjedhojë e sa më sipër, nga kontrolli që Kolegji ushtroi ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi të krijojnë pasurinë apartament banimi në Tiranë dhe të përballonin shpenzimet për diferencën negative në shumën prej (-) 982.983 lekësh, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

13. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të vitit 2015, të kryer nga Komisioni, në lidhje me shlyerjen e shumës prej 7.000 eurosh, huadhënësit A. M.. Sipas subjektit të rivlerësimit, në analizën e Komisionit duhet të ishin marrë në konsideratë pretendimet e tij në lidhje me përlllogaritjen e shpenzimeve të jetesës dhe gjithashtu në lidhje me konsiderimin e të ardhurave nga pemëtaria, nga përlllogaritja e të cilave do të rezultonte se subjekti i rivlerësimit kishte mundësi të kryente shlyerjen e huasë në shumën 7.000 euro dhe përballimin e shpenzimeve të vitit.

13.1 Konkluzionet e Komisionit: *Komisioni, duke marrë në konsideratë pretendimet e subjektit për t’i ulur shpenzimet e jetesës, duke zbritur shportën ushqimore, nga analiza financiare e kryer, subjekti përfundimisht rezultoi me mungesë burimesh të ligjshme në shumën (-) 27.086 lekë për vitin 2015.*

13.2 Nga dokumentacioni i administruar në dosje, trupi gjykues i Kolegjit vëren se subjekti i rivlerësimit ka kryer disa shlyerje në shuma të ndryshme të kësaj huaje. Subjekti i rivlerësimit

ka depozituar mandat arkëtimi nga BKT-ja, me përshkrimin: “Shlyerje detyrimi sipas kontratës së huasë, në favor të A. M.”, për shumën prej 7.000 eurosh në datën 31.12.2015 dhe për shumën prej 5.000 eurosh në datën 04.01.2017. Nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezulton se në datën 10.12.2019, subjekti i rivlerësimit ka transferuar nga llogaria e tij në Raiffeisen Bank, në favor të z. A. M., shumën prej 879.200 lekësh. Nga të dhënat e mësipërme, rezulton se subjekti i rivlerësimit në vitin 2019, ka shlyer nga huaja e marrë, gjithsej shumën 19.100 euro dhe i mbeten pa shlyer edhe rreth 5.900 euro, për të shlyer përfundimisht huanë e marrë prej 25.000 eurosh për blerjen e apartamentit në Tiranë.

13.3 Nga verifikimi i DIPP-ve nga viti 2014 dhe në vijim, subjekti ka deklaruar detyrimin ndaj z. M. dhe shlyerjet përkatëse ndër vite, çka përkojnë edhe lëvizjet bankare të kryera prej tij. Komisioni kreu analizën financiare për të vlerësuar mundësinë e subjektit për të paguar me burime financiare të ligjshme këstin prej 7.000 eurosh, më datë 31.12.2015, si detyrim i mbetur huadhënësit. Nga analiza financiare e kryer në Komision, ka rezultuar mungesë burimesh financiare të ligjshme për pagesën e këstit të huasë në vitin 2015, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 466.286 lekë. Në lidhje me këtë konstatim, nga Komisioni i është kaluar barra e provës subjektit, për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Subjekti i rivlerësimit, në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, ka shpjeguar se Komisioni duhet të marrë në konsideratë të ardhurat e realizuara nga pemëtaria dhe blegtoaria, sipas aktit të ekspertimit të depozituar prej tij në Komision, si dhe të hiqen nga analiza financiare shpenzimet e shportës ushqimore, pasi këto shpenzime janë përballuar nga prodhimet bujqësore e blegtorale të realizuara nga puna e tij dhe e familjes, si rrjedhojë do të rezultojë se ka pasur burime të ligjshme për të bërë pagesën e këstit të huasë, duke rezultuar me balancë pozitive në shumën 573.655 lekë.

13.4 Në lidhje me shpenzimet e jetesës së subjektit të rivlerësimit, nga Komisioni është bërë një zbritje e këtyre shpenzimeve që i përkasin shportës së ushqimeve, duke konsideruar pretendimin e subjektit të rivlerësimit se ai kishte ndihmuar ekonominë e tij familjare me prodhimet në bujqësi. Komisioni ka ndarë nga shpenzimet e jetesës zërin e shpenzimeve për ushqim, duke e zbritur atë nga këto shpenzime sipas përqindjes përkatëse vit pas viti, e cila rezulton mesatarisht 50%. Në analizën e Komisionit, nuk është mbajtur parasysh se gjatë periudhës 2014-2016, dy vajzat e subjektit të rivlerësimit kanë jetuar në Tiranë, ku kanë kryer studimet universitare. Nëse për këtë periudhë do të përlllogariteshin shpenzime jetese për dy persona, pa zbritur shpenzimet e shportës ushqimore, atëherë shpenzimet e jetesës do të rezultinin më të larta se ato të përlllogaritura nga Komisioni. Trupi gjykues i Kolegjit vëren se Komisioni ka zbritur shpenzimet e shportës, në një kohë që ka konkluduar se të ardhurat e pretenduara nga subjekti i rivlerësimit si të krijuara nga pemëtaria, nuk u provuan. Për sa kohë nuk është provuar sasia e këtyre të ardhurave, nuk ekziston qartësia nëse me to subjekti ka mbuluar shpenzimet e shportës së produkteve ushqimore. Në këto kushte, në zbatim të parimit *no reformatio in peius*, mbetet i konfirmuar qëndrimi i Komisionit, i cili ka zbritur disa shpenzime të subjektit të rivlerësimit nga shporta e produkteve ushqimore.

13.5 Në Kolegj u krye kontrolli i analizës financiare të Komisionit, ku u përfshinë të ardhurat e subjektit të rivlerësimit dhe bashkëshortes së tij nga pagat për vitin 2015. Në këtë analizë nuk u përfshinë të ardhurat nga pemëtaria e bujqësia, pasi sasia e përfituar sipas subjektit, mbeti e aprovuar me dokumentacion mbështetës.

Në analizë të sa më sipër, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij nuk kishin mundësi të përballonin shpenzimet e jetesës dhe të shlyenin huanë në shumën 7.000 euro në vitin 2015, për diferencën negative në shumën (-) 27.086 lekë, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

14. Subjekti i rivlerësimit kundërshton analizën financiare të Komisionit për vitin 2016, pasi nuk i janë konsideruar nga Komisioni shpenzimet e jetesës të reduktuara sipas pretendimit të tij dhe gjithashtu nuk janë marrë në konsideratë as të ardhurat nga pemëtaria sipas aktit të ekspertimit të paraqitur nga subjekti në Komision. Subjekti pretendon se shpenzimet e jetesës janë përballuar nga të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe jo nga të ardhurat nga paga, ndaj ulja e shpenzimeve nga Komisioni me 50% nga ato përlllogaritura nga INSTAT-i, nuk është e mjaftueshme, pasi shpenzimet e shportës duhet të jenë në vlerën 30% të të ardhurave neto. Gjithashtu pretendon se, nëse do konsiderohen të ardhura nga pemëtaria si dhe të ulen shpenzimet e jetesës, analiza financiare për periudhën 2003-2014, do të ishte me balancë pozitive. Subjekti pretendon t'i konsiderohet gjendja *cash* në shumën 1.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, të cilën pretendon se e ka krijuar nga kursimet e tij dhe të bashkëshortes dhe të ardhurat e realizuara nga pemëtaria.

14.1 Konkluzioni i Komisionit për gjendjen *cash*: *Duke marrë në konsideratë pjesërisht pretendimet e subjektit në prapësime, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur mjaftueshëm burime të ligjshme për krijimin e gjendjes “cash”, në shumën 1.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën “vetting”.*

14.2 Nga verifikimi i deklarimeve, Komisioni ka konstatuar se ka mospërputhje në deklaratimet e subjektit, pasi në DIPP-në e vitit 2016 ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.500.000 lekë, ndërsa në deklaratën *vetting* ka deklaruar gjendje *cash* në shumën 1.000.000 lekë. Komisioni konsideroi në analizën financiare shumën e deklaruar në DIPP-në e vitit 2016 (1.500.000 lekë). Nga kjo analizë, ka rezultuar se subjekti nuk ka pasur burime të mjaftueshme financiare për krijimin gjendjes *cash*, pasi ka rezultuar me balancë negative në shumën (-) 768.231 lekë. Në lidhje me konstatimet e Komisionit, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në përgjigje të barrës së provës, subjekti i rivlerësimit sqaroi se duhet të konsiderojë të ardhurat nga bujqësia dhe pemëtaria (sipas aktit të ekspertizës të paraqitur pas kalimit të barrës së provës në Komision). Gjithashtu, subjekti ka kërkuar që shpenzimet jetike në fshat të llogariten si të përballuara kryesisht me të ardhurat nga prodhimet bujqësore dhe blegtorale. Subjekti sqaroi se ka pasur burime financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash*, duke rezultuar me bilanc pozitiv në shumën 227.292 lekë. Pas prapësimeve të subjektit të rivlerësimit, analiza financiare në Komision ka rezultuar me balancë negative në shumën 384.103 lekë.

14.3 Lidhur me pretendimin për të konsideruar në analizën financiare të vitit 2016, të ardhurat e përfituara nga pemëtaria dhe bujqësia, trupi gjykues i Kolegjit ka mbajtur qëndrim më sipër në këtë vendim, si rrjedhojë nuk janë përfshirë në analizën financiare të subjektit të rivlerësimit. Nga kontrolli që ushtroi trupi gjykues i Kolegjit ndaj analizës financiare të Komisionit, rezultoi se subjekti i rivlerësimit dhe familja e tij kanë mungesë të burimeve financiare të ligjshme për krijimin e gjendjes *cash* 1.000.000 lekë, të deklaruar në deklaratën *vetting*, si dhe mbulimin e shpenzimeve të kryera për diferencën negative në shumën (-) 384.229 lekë në vitin 2016, duke u gjendur në kushtet e parashikuara nga neni 33, pika 5, germa “b” e ligjit nr. 84/2016.

15. Subjekti i rivlerësimit kundërshton konkluzionin e Komisionit se ushtrimi i veprimtarisë së fermerit është në papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit, duke pretenduar se është regjistruar në Drejtorinë Rajonale të Tatimeve Berat dhe është pajisur me certifikatë regjistrimi, datë 15.11.2016, dhe mbi bazën e këtij akti, familja bujqësore ka realizuar dhe shitjet e prodhimeve bujqësore. Subjekti pretendon se në analizë të nenit 143 të Kushtetutës, nuk ndalohet kjo veprimtari e fermerit, ndaj nuk mund të jetë në papajtueshmëri me këtë dispozitë kushtetuese. Subjekti shpjegon se titullin e fermerit e ka fituar “*ipso jure*” për shkak se ishte kryefamiljar dhe ligji nr. 7501/1991 parashikonte që AMTP-ja i jepej kryefamiljarit si përfaqësues i familjes bujqësore. Gjithashtu, pretendon se ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (në vijim “ligji nr. 96/2016”) nuk parashikon asnjë dispozitë ndaluese për veprimtarinë e fermerit. Në përfundim, pretendon se nuk ka asnjë pengesë ligjore dhe nuk bie ndesh me nenin 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe me asnjë ligj tjetër.

15.1 Konkluzionet e Komisionit për këtë çështje: *Komisioni konstatoi se veprimtaria e fermerit e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit është në papajtueshmëri me detyrën e gjyqtarit, referuar nenit 143 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, ku parashikohet se: "Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit të mësimdhënies, akademik shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit". Veprimtaria e fermerit, e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, është një veprimtari tregtare, e cila ushtrohet kundrejt pagesës në mënyrë të vazhdueshme, dhe subjekti lëshon fatura tatimore në emrin e tij si fermer. Një person nuk mund të jetë në të njëjtën kohë dhe gjyqtar dhe fermer. Ky veprim është i papajtueshëm me figurën e magjistratit, të cilit ligji i ka lejuar të ushtrojë vetëm aktivitetin e mësimdhënies dhe asnjë aktivitet tjetër fitimprurës.*

15.2 Referuar nenit 143 të Kushtetutës, sipas të cilit parashikohet se: *Qenia gjyqtar nuk pajtohet me asnjë veprimtari tjetër politike ose shtetërore, si dhe veprimtari profesionale që ushtrohet kundrejt pagesës, me përjashtim të aktivitetit të mësimdhënies, akademik shkencor, si dhe delegimit pranë institucioneve të sistemit të drejtësisë, sipas ligjit*, Komisioni ka vlerësuar se veprimtaria fitimprurëse e ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, e bujkut apo tregtarit, është e papajtueshme me funksionin e gjyqtarit. Komisioni i është drejtuar ILDKPKI-së me kërkesë¹⁷ për interpretim, nëse ky subjekt, me statusin e gjyqtarit, ndodhet në kushtet e konfliktit të interesit në

¹⁷ Shkresa e Komisionit nr. {***} prot., datë 13.07.2021.

ushtrimin e aktivitetit si fermer. ILDKPKI-ja, në kthim përgjigjen¹⁸ e saj, ka sqaruar Komisionin se i ka dërguar raportin e plotë të datës 30.03.2018, në të cilin janë trajtuar, ndër të tjera, gjendja e të ardhurave të përfituara nga shitja e produkteve bujqësore. Bashkëlidhur, i ka dërguar Komisionit edhe procesverbalet e mbajtura në datat 11.11.2008 dhe 17.11.2014 mes këtij institucioni dhe subjektit të rivlerësimit.

15.3 Lidhur me sa më sipër, Komisioni konstatoi se subjekti, për ushtrimin e aktivitetit privat si “fermer”, është në papajtueshmëri me funksionin e tij. Në lidhje me këto konstatime, subjektit iu kalua barra e provës për të provuar të kundërtën, bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016 dhe në pikën 5 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës. Në prapësimet mbi rezultatet e hetimit, subjekti shpjegon se nuk ka ushtruar aktivitet të papajtueshëm me detyrën e gjyqtarit. Subjekti ka pretenduar se ky qëndrim konfirmohet edhe nga institucionet, si: ILDKPKI-ja dhe KLGj-ja, të cilat nuk shprehen për konflikt interesi apo ushtrim aktiviteti në papajtueshmëri me Kushtetutën. Gjithashtu ka pretenduar se bazuar në nenin 7 të ligjit nr. 96/2016, regjistrimi i tij me NIPT si fermer, nuk përbën papajtueshmëri me funksionin e gjyqtarit.

Në lidhje me aktivitetin e tij të fermerit, subjekti ka pretenduar se ka qenë i rregullt në pagimin e taksave dhe tatimeve për tokën dhe në zbatim të dispozitave ligjore dhe referuar nenit 5 të udhëzimit¹⁹ nr. 19, datë 3.11.2014, subjekti është pajisur me NIPT fermeri. Subjekti ka pretenduar se titullin “fermer” e ka fituar (*ipso jure*) për shkak se është kryefamiljar dhe, sipas Aktit të Marrjes së Tokës në Pronësi, toka jepej në emër të kryefamiljarit, në bazë të ligjit nr. 7501, datë 19.07.1991, “Për tokën”.

15.4 Trupi gjykues i Kolegjit vëren se nga dokumentacioni i administruar në dosje, rezultoi se subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura nga bujqësia dhe pemëtaria në deklaratat periodike në ILDKPKI që nga viti 2003 deri në vitin 2017, përfshirë deklaratën *vetting*. Siç është trajtuar më sipër në këtë vendim, subjekti i rivlerësimit ka përfituar tokë nga ligji nr. 7501/1991, të cilën e ka shfrytëzuar duke mbjellë pemëtari, sipas deklarimeve të tij, në këtë mënyrë ka ushtruar veprimtarinë e fermerit. Në vitin 2016, është regjistruar në Drejtorinë Rajonale Tatimore Berat, për t’u përfshirë në skemën e rimbursimit të TVSh-së për të vetëpunësuarin në bujqësi/fermerin, nëpërmjet së cilës fermerët që kërkonin rimbursim të TVSh-së, duhet të deklaronin shitjet e tyre. Kolegji konstaton se pavarësisht se Komisioni ka konsideruar veprimtarinë e fermerit të ushtruar nga subjekti i rivlerësimit, si të papajtueshme me funksionin e gjyqtarit, në vendimmarrje nuk i ka dhënë peshë për shkarkimin e tij nga detyra, si rrjedhojë vlerësoi se kjo çështje, përveçse jopërcaktuese në vendimmarrje, është pa relevancë për t’ia nënshtruar shqyrtimit në Kolegji.

16. Në përfundim, trupi gjykues i Kolegjit, bazuar në konkluzionet e mësipërme, vlerëson se subjekti i rivlerësimit Nazmi Troka gjendet në kushtet e parashikuara nga neni D, pika 3 e Aneksit të Kushtetutës dhe nenit 61, pika 3 e ligjit nr. 84/2016. Për pasojë, vendimi nr. 472, datë 04.11.2021,

¹⁸ Shkresa e ILDKPKI-së nr. {***} prot., datë 26.07.2021.

¹⁹ “Për zbatimin e regjimit të veçantë të skemës së kompensimit të prodhuesve bujqësorë për qëllime të tatimit mbi vlerën e shtuar”.

i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, për shkarkimin e subjektit të rivlerësimit nga detyra, është i mbështetur në prova e në ligj dhe, si i tillë, duhet të lihet në fuqi.

PËR KËTO ARSYE,

trupi gjykues, bazuar në nenin 66, pika 1, shkronja “a” e ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

VENDOSI:

1. Lënien në fuqi të vendimit nr. 472, datë 04.11.2021, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që i përket subjektit të rivlerësimit Nazmi Troka.
2. Ky vendim është përfundimtar dhe ka efekt të menjëhershëm.

U shpall sot, në Tiranë, më datë 25.11.2024.

ANËTAR

Sokol ÇOMO

nënshkrimi

ANËTARE

Rezarta SCHUETZ

nënshkrimi

ANËTARE

Mimoza TASI

nënshkrimi

RELATORE

Natasha MULAJ

nënshkrimi

KRYESUESE

Albana SHTYLLA

nënshkrimi